



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 MARS 2019, ora 14:00**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. MARTA 2019. GODINE, 14:00 časova**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o zabrani igara na sreću

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra që nuk jeni këtu,
Dhe ministra të kabinetit qeveritar,
Konstatoj që në sallë janë këta që janë. I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas kërkesës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit

Të nderuar deputetë,
Para se të fillojmë me shqyrtimin e parë të këtij projektligji, Kuvendi duhet të vendosë për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e parë dhe për shqyrtimin e dytë.

Meqenëse nuk kemi kuorum për të vendosur shmangien për lexim të parë dhe të dytë, ne fillojmë seancën me ekspozenë e kryeministrit dhe pastaj nëse bëhet kuorumi e votojmë shmangien dhe nëse nuk bëhet vazhdojmë me debatin.

Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Media,

Pra, në përputhje me Nenin 69 të paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kam kërkuar seancë të jashtëzakonshme në të cilën kemi paraqitur projektligjin të cili po e paraqes para jush.

Pra, në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, para jush paraqes Projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit dhe këtë duke u bazuar në rezolutën e Kuvendit të Kosovës me nr. 06/L-016, datë 22 mars 2019, me të cilën kërkohet që Qeveria t'i nisë procedurat ligjore për pezullimin e aktiviteteve të të gjitha llojeve të lojërave të fatit deri në plotësimin e ndryshimit të ligjit përkatës.

Qeveria brenda 30 ditë ta procedojë në Kuvend projektligjin e ri që i ndalon të gjitha llojet e lojërave të fatit për periudhën 10-vjeçare, opsioni është i rekomanduar.

Pra, miratimi i Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit me të cilin ndalohen të gjitha lojërat e fatit me përjashtim të Lotarisë së Kosovës. Me këtë projektligj ndalohen lojërat e fatit me përjashtim të Lotarisë së Kosovës, e cila është subjekt juridik, publik.

Andaj, ju propozoj që ta miratoni këtë projektligj me qëllim të rregullimit të kësaj çështjeje dhe forcimit të sigurisë publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë në pauzë deri në orën 16:00 për shkak se nuk ka kuorum për t'u votuar dhe besoj që atëherë do të bëhet kuorumi dhe vazhdojmë me seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Jemi në vazhdimin e seancës.

Të nderuar kolegë deputetë,

E kemi dëgjuar ekspozenë e kryeministrit, është seancë e jashtëzakonshme.

Për të vazhduar më tutje seancën duhet t'i shmangemi Rregullores me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

Presim deri të bëhen 61, i kemi edhe disa deputetë në një takim zyrtar, me aq sa e di unë, janë 7, 8 a 10.

Urdhëro, zonja deputete, edhe ashtu jemi duke pritur!

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj!

Meqenëse pak më herët jemi kthyer nga Podujeva, ku është shënuar 20-vjetori i masakrës mbi familjen Bogujevci dhe familjen Duriqi. Siç e dini, janë vrarë 7 fëmijë dhe 7 gra. Ishte një masakër aq e rëndë, ku njësi famëkeq "Shkorpionët" edhe sot e kësaj dite nuk e mori dënimin merit. Një vit më herët ekzekutori dhe krimineli famëkeq, të cilit nuk dua t'ia përmend emrin, duke u nisur nga thënia e kryeministres së Zelandës së Re, e cila tha të mos i përmendim më emrat e kriminelëve, por t'i përmendim emrat e viktimave.

Unë do ta përmend vetëm një emër, Saranda Bogujevci, një deputete që sot është e mbijetuar, është deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe besoj që është simbol apo simbolizon

gjithë fëmijët viktima, por fati i saj ishte që ajo është e mbijetuar dhe sot është në mesin tonë, edhe pse jo sot këtu.

Prandaj, nga Saranda dhe të gjithë fëmijët e mbijetuar kam marrë këtë simbol që ta përcjell këtu te ju, të punuar nga duart e fëmijëve të Podujevës, të cilët kërkuan një gjë nga ne: të mos harrohen të gjithë fëmijët viktima të luftës, por edhe të bëhet shumë më shumë për të gjithë fëmijët që sot jetojnë në Kosovë dhe të cilët kanë nevojë për mbështetje institucionale.

Prandaj, këtë po e lë këtu në foltore, që së paku sot të gjithë të jemi në kujtim me të gjitha viktimat, e në veçanti me fëmijët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Do të bëjmë 15 minuta pauzë, po do ta vazhdojmë sonte, deputetët le të vijnë në sallë. Unë mund ta lë edhe të hapur, nuk keni pse të lëvizni, në momentin si të bëhen 61, ne vazhdojmë, po ta keni parasysh, më mirë është të kemi 15 minuta pauzë, shpresojmë që do të vijnë edhe deputetët që janë në takim zyrtar, se janë nga shumica e grupeve parlamentare, me aq sa di unë, nga një deputet.

Atëherë, në orën 14:35 e vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Vazhdojmë seancën.

Kemi kuorum të mjaftueshëm, 63 deputetë.

Do të thotë për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

Kërkohet votim për këtë shmangie nga Rregullorja, në qoftë se nuk ka deklarime, shkojmë në votim drejtpërdrejt.

Votojmë në mënyrë elektronike, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 61 për, një abstenim. Do të thotë, kemi vendosur për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e parë dhe shqyrtimin e dytë të këtij projektligji.

Konstatoj se Kuvendi e mori këtë vendim.

Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit bëhet me procedurë të përshtetshme, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe neni 56, paragrafi 1.1, neni 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 dhe neni 64, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit si në vijim:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit bëhet në seancën e jashtëzakonshme më 28 mars 2019.

Amendamentet në projektligjin nga pika 1.1 të këtij vendimi mund t'i adresohen Komisionit Funkcional menjëherë pas miratimit në shqyrtim të parë.

Pas miratimit në shqyrtim të parë, Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancën plenare.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit bëhet në seancën e veçantë plenare në ditën e sotshme, do të thotë më 28 mars 2019, në orën 18:00 ose 19.00, se në mënyrë formale komisionet formalisht duhet t'i shqyrtojnë.

A jeni më shumë 18:00-19:00? Në orën 18:00, atëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1. Shqyrtimin e parë të Projektligjit numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Në qoftë se dëshiron dikush fjalën, a po shkojmë drejt e votojmë. Lumir Abdixhiku në emër të Komisionit për arsyetimin e raportit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Unë në fakt e kam edhe një kërkesë në emër të komisionit ta parashtroj këtu, mirë që është ministri i Financave, meqë na duhet një qartësim, ka një paradoks ligjor që është krijuar me dy intervenimet. Në njërin anë, sipas Zyrës Ligjore të Kuvendit, pra, që është prezantuar në Kuvend. Në njërin anë bëhet shfuqizimi i ligjit paraprak, po në anën tjetër mbesin nenet që e rregullojnë Lotarinë e Kosovës.

Pra, në qoftë se e shfuqizojmë ligjin, e i mbajmë nenet e Lotarisë, ato nene ku rrinë, me cilin ligj rrinë ato. Ideja është t'i diskutojmë apo e shfuqizojmë edhe Lotarinë e Kosovës, a po e mbajmë

Lotarinë e Kosovës. Nëse e mbajmë Lotarinë e Kosovës, atëherë në këtë ligjin e ri duhet shtuar nenet e Lotarisë së Kosovës, ose po e bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit aktual, e po i shfrytëzojmë vetëm nenet e lojërave të fatit.

Këto dy gjëra është mirë Qeveria të na i qartësojë. Faleminderit!

KRYETARI: Komisioni mund ta përcaktojë, po është një propozim. Ne në ligjin e ri i futim vetëm lojërat e fatit, edhe të tjerat në qoftë se Kuvendi vendos, vetëm Lotarinë, lojërat e fatit të gjitha ndalohen sot.

Arbeni, në qoftë se ka diçka sqarim procedural, po të keni parasys, e kemi leximin e parë dhe të dytë, do të thotë kemi kohë. Arben, na ndihmo.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

E kemi diskutuar edhe me kolegët, edhe me Naserin, edhe me Lumirin këtë çështje. Vërejtja e Kuvendit është e saktë, sepse nëse shfuqizohet ligji, nuk mund të mbetet në fuqi një dispozitë e tij.

Pra, në këtë rast mund të transpozohen, të bartet neni komplet prej ligjit aktual në ligjin e ri, që ka të bëjë me Lotarinë e Kosovës, vetëm nenet që kanë të bëjnë me Lotarinë e Kosovës, të tjerat shfuqizohen dhe kemi një ligj të ri.

Përndryshe, do të duhej të kishim Projektligj për plotësim dhe ndryshim të ligjit në fuqi. Pra, nëse ne e shfuqizojmë ligjin aktual, i transpozojmë normat që kanë të bëjnë me Lotarinë e Kosovës, që është institucion shtetëror i Kosovës, ndërmarrje publike, me sa e kuptoj unë, zoti ministër, dhe ka monopolin e organizimit të këtyre lojërave në emër të shtetit të Kosovës dhe rregullohet, mbyllet kjo çështje, të gjitha të tjerat mbesin të mbyllura dhe vetëm kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe nuk ka më dyshime për asgjë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, leximin e parë ne e vazhdojmë, në leximin e dytë këto vërejtje të cilat janë të drejta futen.

Vetëm kisha lutur, mos na krijoni ndonjë, siç thonë në gjuhën popullore, ndonjë kleçkë, pastaj t'i leni lojërat e fatit.

Atëherë, a po vazhdojmë drejtpërdrejt në leximin.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, a e dëshirojnë fjalën? Po.

Atëherë shkojmë kështu. Nga Safete Hadërgjonaj, po e shoh. Nga LDK-ja, a ishte Lumiri?

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen mirë që sot kemi në lexim të parë Projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit.

Me sa kemi pasur rastin të shohim përmes mjeteve të informimit, kjo çështje është diskutuar edhe më përpara në Qeveri, këtë çështje në Qeveri e ka ngritur ministri i Financave, zoti Bedri Hamza, që këto lojëra të fatit të mbyllen.

Ka pasur debate dhe diskutime disa herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës në lidhje me këto lojëra të fatit, ka pasur kërkesa të ndryshme për t'i mbyllur, për t'i reduktuar, e forma të ndryshme, por më vjen mirë që Qeveria ka ndërhyrë shumë shpejtë dhe pas nxjerrjes së rezolutës nga Kuvendi, menjëherë ka sjellë Projektligjin për shfuqizimin e lojërave të fatit.

Ne sot kemi mbajtur një mbledhje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kemi përkrahur këtë projektligj, po e kemi pasur një ndërhyrje nga Zyra Ligjore e Kuvendit, ku na ka tërhequr vërejtjen që duhet ta rregullojmë çështjen e Lotarisë së Kosovës, nëse veç duam ta mbajmë Lotarinë e Kosovës për të gjetur mënyrën e rregullimit përmes këtij projektligji apo formën më të përshtatshme.

Sot në Komisionin për Buxhet e kemi diskutuar këtë çështje, besoj që kjo nuk do të jetë problem i madh dhe do ta gjejmë mënyrën për ta rregulluar gjatë shqyrtimit në lexim të dytë të këtij projektligji.

Ne si grup parlamentar do ta përkrahim dhe do ta japim kontributin tonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arbërie Nagavci, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Edhe ne si Lëvizje Vetëvendosje në parim pajtohemi me këtë ligj. Përpos çështjeve që i ngriti deputeti Abdixhiku që u diskutuan tashmë, me të cilat pajtohemi, është edhe një çështje që e konsiderojmë të rëndësishme ta paraqesim këtu. Saktësisht një amendament, i cili konsiderojmë se duhet të jetë pjesë e ligjit, e që ka të bëjë me përcaktimin se Lotaria e Kosovës, si subjekt juridiko-publik, nuk mund të organizojë dhe të realizojë bashkëpunim me subjekte juridiko private në çështje që kanë të bëjnë në pjesëmarrje në kapital dhe në ndarje të fitimit përmes ndonjë marrëveshje apo kontrate të veçantë.

Arsyeja sepse i kemi parashikuar, e kemi paraqitur këtë amendament, ka të bëjë me faktin se në Ligjin për lojërat e fatit, në nenin 9, i cili ka të bëjë me Lotarinë, ndër të tjera përmendet që veprimtari dhe çështjet që rregullojnë punën e Lotarinë së Kosovës përcaktohen me statut.

Ndërkohë që në statut, në nenin 3, sa i përket veprimtarisë, përmendet që Lotaria e Kosovës mund të organizojë lojëra të ngjashme të cilat kanë rezultat, gjegjësisht bazohen në rastësi dhe pastaj, specifikisht në nenin 7, e përcakton që lojërat e Lotarisë nga neni 3, pra ato që ka të drejtë t'i organizojë lotaria, mund t'i organizojë në bashkëpunim edhe me lotaritë e shteteve të tjera si dhe në bashkëpunim me afaristë me subjekte të tjera juridike, të regjistruara si tregtare, zejtare, hoteliere e të tjera, ndër të tjera edhe për transaksionin e mallrave dhe të shërbimeve.

Më tutje, në nenin 6, sa i përket ndarjes së fitimit dhe sistemit të të ardhurave parashihet se Lotaria e Kosovës organizon lojëra të përbashkëta në bashkëpunim me lotaritë e shteteve të tjera ose në bashkëpunim me persona të huaj juridik çështje që kanë të bëjnë me pjesëmarrje me kapitalin, ndarjen e fitimit dhe bartjen e rrezikut, në afarizëm rregullohen me kontratë të veçantë.

Pra, duke pasur parasysh se Lotaria e Kosovës është subjekt juridiko-publik, ne konsiderojmë se duhet të ekzistojë edhe ky nen i veçantë, i cili ndalon që Lotaria e Kosovës të lidhë marrëdhënie kontraktuale apo kontrata të veçanta me subjekte juridiko-private.

KRYETARI: Faleminderit! Salih Salihu, nga Partia Socialdemokrate.

SALIH SALIHU: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate në parim e përkrah këtë projektligj dhe, në ndërkohë, ndërmjet dy leximeve, do ta japim kontributin tonë në këtë projektligj, që ka të bëjë me ndalimin e lojërave të fatit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi. Unë po e lexoj kush e kërkon fjalën në bazë të grupeve parlamentare, pastaj edhe deputetët.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Për të mos marrë shumë kohë, e përkrahim, në leximin e dytë japim kontributin tonë.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne e përkrahim gjithsesi, në mes të dy leximeve, sigurisht e shkurtër do të jetë koha mes këtyre dy leximeve, do të japim kontributin tonë, nuk di çfarë kontributi më mund të jepet, thjesht votohet edhe në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fikrim Damka, nga Grupi Parlamentar 6+.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e përkrah në parim Projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit.

KRYETARI: Faleminderit! Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi bërë një veprim me kërkesën e Kuvendit për të ndaluar lojërat e fatit, ka qenë një veprim goxha i ngutshëm, pa i marrë parasysh ligjet, tash duhet ndryshuar ligjet, megjithatë është mirë, por ne duhet të kemi kujdes që të respektojmë ligjet, se as Kuvendi dhe as Qeveria nuk është mbi ligjet. Fundi i fundit, ne i kemi bërë vetë këto, por s'mund t'i prishim mandej jashtë kontratës dhe afateve që janë.

Sidoqoftë, unë kam marrë këtë propozimin e Qeverisë, këtu e kam para vetes, janë disa gjëra, përveç vërejtjeve që iu dhanë, se duhet të ketë një ligj të ri, ku qëndrojnë normat për Lotarinë e Kosovës, sepse ato vetvetiu nuk mund të qëndrojnë. Është edhe një çështje tjetër që edhe amendamenti që propozoi zonja Nagavci që ta shkëpusë Lotarinë e Kosovës nga institucionet e tjera juridiko-private, në të vërtetë kanë qenë thelbi i kërkesës së Kuvendit për ndalimin e lojërave të fatit, ku janë lojërat e fatit, domethënë fizike, të drejtpërdrejta, me pasojat që i kemi parë ne. Mirëpo, edhe bartja e, ta quaj kështu, të kapitullit të dytë të lojërave të fatit që ka të bëjë me Lotarinë e Kosovës duhet të shikohet me shumë kujdes dhe të pastrohet nga të gjitha ato norma që hapin derëza apo deriçka të vogla që lejojnë në të vërtetë edhe ekzistencën e ndonjë institucioni juridiko-privat që merret me lojëra të fatit. Nuk po i përmend çfarë, janë kryesisht ato fizike, këtu ka disa nga normat nga të cilat duhet të pastrohet pjesa e Lotarisë së Kosovës, unë kam parë domethënë nenin 10, paragrafin 1.7, në nenin 11 dhe në nenin 12.

Unë nuk jam shumë i sigurt se Kuvendi do të ketë mundësinë thjesht kohore dhe fizike që sot ta kryejë këtë punë, ta pastrojë tekstin ashtu sipas kërkesës së Kuvendit dhe sipas kërkesës së ligjit dhe ta bëjë një ligj të ri. Prandaj, duhet ta mendoni të gjithë kolegët dhe koleget deputete, edhe Qeveria duhet ta mendojë mirë kohën e mjaftueshme që deputetët dhe të gjithë ata që janë të interesuar të paraqesin amendamentet e tyre dhe ta bëjnë një ligj sipas kërkesës dhe kuptimit të seancës së fundit të Kuvendit që ka kërkuar, në të vërtetë, ndërprerjen e lojërave të fatit apo nxjerrjen nga ligji, apo gjithçka tjetër. Ky është propozimi im, ne sigurisht do të japim vërejtjet tona dhe amendamentet tona, po unë kam shqetësimin se koha do të jetë shumë e shkurtër për të mundur që në komisione të trajtohen të gjitha këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrin,

Për mua është e padrejtë të krijohet monopoli, nëse doni ta ktheni sistemin socialist, mund të mendoni edhe ta ktheni, po vendosja e monopolit për rrethana politike, për demokracinë e sotshme, është absurde. Kërkohej që të gjitha lotaritë të ndalen, veç Lotarisë së Kosovës, kjo tregon monopolin e shtetit mbi shoqëritë aksionare.

Rasti që është marrë për shkas për ndërprerje, unë e kam një kërkesë nga vëllai i policit që e ka bërë vrasjen në kazonë në Suharekë, nga Sami Spahiu. Polici në fjalë ka qenë i akuzuar dhe shtatë muaj ka qenë pjesë e paraburgimit për dhunim seksual dhe është liruar i pafajshëm. Policia e Kosovës e ka pranuar përsëri dhe ia ka besuar armën. Kërkesa e dytë është po ashtu polici në fjalë, Shefki Spahiu, ka rënë nga kati i dytë, ka pësuar traumë, ka qenë pjesë e Spitalit Neuropsikiatrik në Prishtinë, QKUK, edhe raporti mjekësor, edhe fletëdalja, lëshimi e dëshmojnë këtë. Pas kësaj prapë është pranuar në polici, është pranuar polic dhe iu ka besuar arma për siguri. Këtu tregon se sistemi policor, rekrutimi atje, ata që kanë këmbëngulur për t'iu rritur pagat edhe t'i mbrojmë me paga, kanë bërë shkelje, të cilat e kanë lejuar vrasjen. Përndryshe, ky të ishte i dënues për dhunim seksual, nuk do të ishte si rast, të përsëritej, po të ishte vlerësuar shkalla e pasojave të spitalit të Prishtinës, QKUK-së, Neuropsikiatrisë, prapë nuk do të ishte rekrutuar, një njeri i sëmurë është lejuar të jetë pjesë e Policisë së Kosovës. Dhe, mbyllja e lojërave të fatit, krejt u deklaruar për, krejt u deklaruar për monopolin, kjo është çudia e Kuvendit të Kosovës, çudia e demokracisë, çudia e zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe tregut të lirë.

Mendoni që nëse kthehemi mbrapa dhe japim vetëm Lotarinë e Kosovës, siç është parashkruar në nenin 1 qëllimi i këtij ligji, në këtë ligj ndalohen të gjitha lojërat e fatit, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës. Atëherë, po kërkohej që gjithë sistemin ta kthejmë në shtetëzim dhe ta bëjmë çdo gjë shtetërore, sikur ka qenë para të '90-tës ose para '99-tës, një ekonomi e centralizuar e shtetit dhe nuk kemi pasur ekonomi të tregut. Nëse ju doni ekonomi të tregut, doni zhvillim të vendit, atëherë tregoni kah, këndeje deklaroheni që jemi pjesë e Bashkimit Evropian, pjesë e lirisë, pjesë e zhvillimit, pjesë edhe të lojërave e të gjithave, e në anën tjetër deklaroheni se doni të bëni centralizmin e shtetit, edhe unë po pajtohem me juve. Të themi që jemi shtet socialistë dhe këtu s'kemi nevojë për debate. Qysh vendos kryetari, kryeministri, presidenti, ne veç bëjmë amin. Prandaj, një ekonomi shtetërore dhe e mbyllim këtë çështje.

Për çka kemi nevojë të debatojmë ne këtu? Cila është arsyeja? Ju paskeni vendosur në ligj të mbylljen, edhe mbylljen, veç nuk di tash e kujt është kjo, por megjithatë le të mbetet çështje e ndërjegjes, e përgjegjësisë dhe atyre që vendosin në formën e tillë. Nuk e di a pajtohet ministri i Financave, nëse është në ekonominë liberale nuk pajtohet me këtë formë, nëse pajtohet me shtetëzimin ose ekonomia e shtetit, e kështu e kështu të tjera qysh i kemi pasur, edhe thotë "të gjitha lojërat, përveç kësaj", hyn në fuqi. Lumiri e pati më herët, tha që nëse i heqim këto, ku bazohet kjo? Domethënë, këtu s'kemi bazament të ligjit, ne do të heqim diçka dhe nuk do të dimë çka të lëmë.

I nderuar kryetar,

Unë nuk i kam syzet e Bilallit, por po kërkoj që ta shikoni mirë dhe një herë këtë, doni të shkoni kah Evropa dhe ekonominë e tregut liberale evropiane, apo doni të ktheheni nga ekonomia shtetërore, shtetëzimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir të qartësisimit publik, Kuvendi nuk ka kontratë me asnjë ligj, se Kuvendi në moment që nxjerr ligjin e ri, e zhvlerëson cilindo ligj që ka qenë. Do të thotë, të mos shqetësohet askush, çdo veprim i cili do të ndërmerret sot, do të ketë bazamentin e plotë në respektim të Kushtetutës edhe ligjeve të Republikës së Kosovës, mbrojtjes së familjes sonë tradicionale, ky është qëllimi.

Shkojmë, a ta ka përmendur emrin? Lumirit veç ia ka përmendur, kurrkujt tjetër, e di Lumiri s'ka kërkuar. Po, të ka përmendur, po me syza po. Fjala për ty!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Unë e dëgjova me vëmendje fjalën e Naitit, edhe Naiti ka ngacmuar Lotarinë dhe lojërat e fatit, këto klasiket që janë, unë nuk besoj që në kuadër të lojërave të tjera të fatit ka një lotari që është mbyllur, pra rrjedhimisht nuk është duke u bërë një ligj, përmes të cilit do të forcohej monopoli i Lotarisë. Po të pyetëm unë, edhe Lotarinë e kisha mbyllur, se nuk ka ndonjë tradite këtu te ne për lotari, por ne jse, ashtu ka vendosur Qeveria që ta kursejë kësaj radhe Lotarinë, është në rregull ajo, nuk kam ndonjë problem, por nuk është se problemet në vend i kemi për shkak të Lotarisë, por varësinë e madhe që kanë shkaktuar lojërat e fatit, të tjera, sidomos këto të kazinove, njerëzit që kanë krijuar varësi ndaj këtyre lojërave është vërtet shqetësuese, mirë po bëhet që po ndalen, po unë nuk mendoj, po e përsëris, nuk mendoj që jemi duke e zgjidhur problemin e lojërave të fatit. Ne vetëm jemi duke i detyruar që të zhvendosen, sepse ata do t'ia mësyjnë Gjevgjelisë, ata që janë të varur, ose do t'ia mësyjnë Shkupit, Podgoricë, do t'ua mësyjnë shumë vendeve të tjera.

Pra, ne duhet të fillojmë një fushatë, Qeveria, Parlamenti, të fillojmë të merremi me këtë kategori të njerëzve, të cilët kanë krijuar varësi dhe do të kërkojnë vende për ta ushtruar apo për të shkuar për t'u shfry, për t'i zhvilluar sërish ato aktivitete. Keni parasysh që na pret një punë e madhe, sidomos Qeveria, e cila i përshpejtoi këta hapa përmes sjelljes së ligjit në lexim të parë, në lexim të dytë, e ka urgjente të mendojë një strategji për të trajtuar fenomenin e tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë, Naiti.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Për Bilallin unë veç mund të them që nuk kam ngatërruar asgjë, unë vetëm e shoh shtetëzimin e ekonomisë dhe mbylljen e ekonomisë të tregut. Domethënë, ekonominë liberale dhe, në anën tjetër me këtë e shoh që duhet të kthehemi në ato kooperativat e vitit '48, '49, Byrosë informative, i bie kjo që Kuvendi i Kosovës sot krijon format e mbylljes dhe krijimin e

shtetëzimit në ato kooperativat që i kemi, edhe kjo do të jetë një formë e tillë, një kooperativë që do të na lejojë mundësinë e fatit.

Unë s'kam luajtur asnjëherë, por po më vjen keq kush ka luajtur, tash e paska mundësinë të luajë veç në Lotarinë e Kosovës. Në Lotarinë e Kosovës ndoshta shpëtojnë pa u vrarë ndokush, e aty ka vrasje tjera, ekonomike, por megjithatë unë e falënderoj Bilallin për qartësinë që mund të shkohet edhe në Shkup.

KRYETARI: Tani Haxhi Avdyli e ka fjalën, i kemi edhe tre deputetë.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Gjatë përvojës time si mjek kam takuar njerëz të ndryshëm, me fate të këqija nga sëmundjet, kam takuar pacient me varësi edhe nga duhani, alkooli dhe droga, por njerëzit me varësi nga bixhozi kanë qenë rastet më të rënda. Këta njerëz, të cilët kanë këtë varësi nuk e dëmtojnë vetëm veten e tyre, sepse dëmtimi i vetes është dëmtim personal, por ky dëmtimi është më i gjerë, dëmtojnë familjen, rrethin dhe ardhmërinë e fëmijëve të tyre dhe rrethinës ku jetojnë. Këta njerëz, të cilët më ka rënë të takoj edhe familjet e tyre, kanë shkaktuar dëme dhe fatkeqësi të mëdha në familjet e tyre, duke u futur në borxhe me kamata vetëm për të shëruar varësinë e tyre që kanë ndaj kësaj anomalie. Kanë dëmtuar rëndë dhe po dëmtojnë familjet dhe ekonominë e tyre dhe shpeshherë këta njerëz, të cilët janë të pafajshëm, sepse kur fillon kjo varësi, shpeshherë edhe ata nuk mund ta ndalin veten, futen aq thellë sa vjen deri te momenti i shkaktimit të vetëvrasjes.

Numri i njerëzve me vetëvrasje që janë të varur nga bixhozi është shumë i lartë, kur ia shtojmë kësaj edhe eksetet, të cilat ndodhin në këto vende, eksetet ndërmjet grupeve, njerëzve, duke shkaktuar vrasje të njëri-tjetrit, atëherë tregon se sa e rëndë dhe sa e keqe është për shoqërinë tonë. Sot ne jemi këtu që me votën tonë mund të shpëtojmë qindra familje nga shkatërrimet, divorcet dhe tendencat e vetëvrasjeve. Unë shpeshherë gjatë debateve që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe jam çuditur edhe me njerëz nga Qeveria, por edhe me ekspertë ekonomikë që thonë se mbyllja e tyre po shkatërron ekonominë dhe po lë njerëzit pa punë. Nëse elementi përbërës apo themelor i shtetit dhe i një shoqërie është familje, atëherë baza e ekonomisë shtetërore mbetet ekonomia familjare. Sot me ndalimin e kazinove fiton familja dhe ekonomia e tyre, por në të njëjtën kohë, në mënyrë indirekte fiton edhe ekonomia e shtetit. Sepse, nëse këto familje shkatërrohen, atëherë çka na nevojitet neve që një grup i njerëzve të lidhur me nëntokën e kimit të jenë përfitues në kurriz të këtyre familjeve.

Këta njerëz të nëntokës, të kimit, po përfitojnë nga sëmundja e varësisë të këtyre njerëzve pa e çarë aspak kokën për shkatërrimin, për dëmtimin që i bëjnë shoqërisë sonë. Unë bëj apel që të gjithë deputetët, pa marrë parasysh bindjet, të votojnë në të mirë të familjeve, në të mirë të ardhmërisë, sepse numri më i madh i këtyre njerëzve janë të rinj, të cilët kanë krijuar këtë varësi

dhe nuk po mund ta shërojnë. Ndërsa, sa i përket Lotarisë që doli si problem këtu, unë shpresoj që do të gjenden modalitete ligjore që edhe ajo si një lotari e organizuar nga shteti dhe e ligjshme të gjenden modalitete ligjore, por nëse çmimi i mbetjes së lotarisë shtetërore është edhe me mbetjen e vazhdimit të kazinove, atëherë më mirë është që t'i mbyllim të gjitha dhe në ndërkohë për Lotarinë të krijojmë infrastrukturë të re ligjore, të veçantë dhe ta rregullojmë me ligj, në mënyrën më të mirë, siç i bëjnë vendet e ndryshme.

Unë shpresoj që nga ky takim do të dalim me sukses dhe pritjet, të cilat i kanë qytetarët, numri më i madh i qytetarëve, mund të themi 99% e qytetarëve që po presin që sot ne t'i ndalojmë kazinotë dhe bixhozin, do ta realizojmë pritjet e tyre, ndërsa ata të dëshpëruarit, ai 1% i përfitueseve, do të zhgënjehen, por me rëndësi është që shoqëria jonë po përfiton. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar nënkryetarë,

Kolegë deputetë,

Një ligj i shumëpritur nga qytetarët e Republikës së Kosovës, për t'u dhënë fund lojërave të fatit, mbylljes së kazinove, i dëshiruar nga të gjithë.

Por, përtej kësaj duhet shikuar, sepse a vërtet me këtë ligj po mbyllen të gjitha lojërat e fatit? Parimisht, jam që vërtet të mbyllen të gjitha kazinotë dhe lojërat e fatit. Me këtë ligj ne nuk po i mbyllim lojërat e fatit, po e krijojmë një monopol, po krijohet monopoli te Lotaria e Kosovës dhe unë jam që të mbyllen tërësisht të gjitha lojërat e fatit. Por, nganjëherë ngutja mund të na dërgojë edhe te gabimet. Më mirë është të bëjmë mirë dhe pa nguti, pa krijuar monopole e të lejojmë sepse tani më, nëse ka pasur plaçkitës në kazino, tani e kanë veç një adresë, veç në Lotari të Kosovës atje duhet të presin me rend plaçkitësit e kriminelët që të plaçkitin të tjerët. Pra nuk është se po i mbyllim lojërat e fatit me këtë ligj, por po e krijojmë një monopol që unë mendoj se nuk do të duhej ta bënim kështu.

Pastaj, ata që janë njohës të kësaj fushe, thonë se duhet t'i dallojmë lojërat e fatit dhe bastet. A janë bastoret, bastet, lojëra të fatit. A është "jadeci" bast, a është lojë e fatit? A është bast? Prandaj, po mendoj që komisioni përkatës në këtë rast, është komisioni funksional në këtë rast, ta bëjë punën e vet, të na e sjellë këtë projektligj në mënyrën që nëse i mbyllim, po i mbyllim të gjithë. Po edhe nëse ndonjë deputet e zëmë duke luajtur "jadec", edhe ata ta ndëshkojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Komisioni e përcakton në fund të fundit edhe shfuqizimin. Mimoza Kusari-Lila, urdhëro!

MIMOZA KUSARI-LILA: Të nderuar deputetë,

Unë e kam një pyetje për të gjithë ju, sinqerisht: a jeni me të vërtetë kaq lehtë të manipulueshëm, me secilin problem veç kemi për të filluar dhe për t'i mbyllur krejt gjërat të cilat funksionojnë. Funksionimi i lojërave të fatit është dështim i krejt sistemit. Vrasja e dy rojeve ose sigurimit në kazino është dështim i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Edhe mbyllja e lojërave të fatit, në orën 17:00 leximi i parë, në orën 18:00 leximi i dytë, është mbulim i krejt krimeve dhe amnisti për të gjithë ata që kanë pasur përgjegjësi për shpërndarjen e lojërave të fatit deri në masën të cilën janë sot.

Ju flas me përgjegjësi të plotë, si kryetare e Komunës, kemi filluar iniciativën t'i mbyllim lojërat e fati afër shkollave. Ne i mbyllnin para ditës, Ministria vinte të më tregonte sesi nuk është 500 metra distanca që e kemi mat ne, po di duhet t'i bie me diagonale, rreth e rrethërotull e ashtu dilte se ato duhet të mbeten hapur.

Çka ndodhi deri tash me lojërat e fatit? Çka ndodhi me gjithë ato tragjedi familjare, ekonomike e sociale, me krim, kontrabandë, e shpeshherë edhe prostitucion në këto hapësira, edhe tash përnjëherë po i mbyllim për një orë. Shpejtësia është prodhim i dreqit. Jam për atë që të kemi procedurë ligjore të mbylljes së lojërave të fatit në proces, por gjithashtu edhe vlerësim të asaj se kush e ka shkelur ligjin, edhe çka ka ndodhur për të gjithë ata persona të implikuar, qoftë në nivelin e institucioneve, qoftë në nivelin e sektorit privat, që sot vetëm po duan të mbyllën.

Dhe nëse po mbyllim lojërat e fatit, atëherë po i mbyllim edhe bankat. Po i mbyllim bankat, se kështu ashtu fajdetë po bëhen. Se do të fillojmë të kemi lojëra të fatit të cilat do të zhvillohen ilegalisht. Kanë për të vazhduar të gjitha aktivitetet në formën ilegale. Prapë kemi për të pasur një Ministri të Punëve të Brendshme, jokompetente për të ndjekur kriminelët, për t'i ndjekur ata që ilegalisht po merren me lojëra të fatit. Shpejtësia edhe një herë është prodhim i dreqit. Prej vitit 2011 e mbaj, e përcjell punën e Kuvendit, edhe sa herë që është votuar diçka me shpejtësi është kthyer bumerang. Qoftë në ndryshime kushtetuese, qoftë në procedime të ndryshimit të ligjit. Pse ne duhet të votojmë për një projektligj brenda ditës, në orën 17:00 leximi i parë, në orën 18:00 leximi i dytë. Për kë? Nuk na ka ndodhur asnjëherë. Ju kisha lutur, kjo është veprimtari ekonomike, të cilën kemi dështuar si shtet ta rregullojmë, që kemi marrë në qafë familje e gjenerata të tëra, që i kemi infiltruar dhe i keni kontrabanduar, edhe keni pasur shumë aktivitete ilegale që kanë ndodhur.

Lojërat e fatit duhet të hyjnë në një proces i cili së pari duhet të jetë ministri i Brendshëm këtu të japë llogari, edhe të tregojë se çka ka ndodhur me krejt atë që s'është rregulluar deri më tash. Duhet të jetë komplet Qeveria e cila raporton për aktivitetin, për numrin, për hapësirat të cilat janë shfrytëzuar, edhe për shumë aktivitete të tjera bashkë me lojërat e fatit, e mandej po shkojmë edhe po e marrim këtë proces me një afat kohor. Ne nuk jemi as shtet diktatorial, as nuk jemi shtet Kore e Veriut, nuk e di, se Koreja e Veriut për një orë kishte mundur të marrë një

vendim të tillë, por jemi shtet i cili ishte dashur në aspektin social, edhe ekonomik të bëjë një analizë të mirëfilltë. Çka do të ndodhë me gjithë ato aparate të lojërave të fatit që janë brenda hapësirave? Kush e bën kontrollimin e largimit të aparaturave? Kush siguron që ato aparatura nuk shkojnë nëpër podrume të shtëpive e të hapësirave edhe vazhdojnë lojërat e fatit ilegale.

Me këtë sistem të drejtësisë që e kemi, kanë për të vazhduar bile edhe më tepër. Ju kisha lutur, nëse keni pak vëmendje, edhe nëse kemi interesim që ta rregullojmë këtë çështje, të sigurohemi që mbyllen hapësirat sipas ligjit aktual, pranë shkollave, pranë bashkësive fetare, pranë hapësirave të vendbanimeve dhe pastaj gradualisht të bëhet një listë e mirëfilltë, po jo të amnistohen të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij krimi të organizuar, me një ligj i cili votohet për një orë komplet edhe mandej hajde se na ka mbetur veç Lotaria. Jo! Ka shumë elemente të lojërave të fatit të cilat duhet në veçanti të analizohen, për të ardhur deri te konkluzioni e plotë, edhe te mbyllja, nëse shkojmë deri në mbyllje absolute. Po ju e dini se secili akt normativ i kësaj natyre nuk e prodhon në njëfarë forme lirim nga kjo dukuri. Në të kundërtën. Holanda është vendi në të cilin më së paku holandezët, njerëzit aty, konsumojnë marihuanën që është e legalizuar. Në krejt vendet e tjera që është e ndaluar, ka rritje ose ka më tepër shfrytëzim. Me të gjitha dukuritë e tjera ka për të ndodhur e njëjta.

Molla e ndaluar, lojërat e fatit kanë për të lulëzuar ilegalisht. Shteti ka dështuar t'i rregulloj ato që e ka pasur me ligj, e tash po vijmë edhe për një orë po i mbyllim krejt. Diçka s'është në rregull. Ose le të vijmë le të na tregojnë cila është arsyeja? Nuk është mënyra më e mirë e mbylljes, ose rregullimi i kësaj dukurie për një orë ne t'i mbyllim krejt komplet. Mbyllini aty ku duhet të mbyllen, po jo ju kisha lutur mos na ofendoni inteligjencën. Me një ligj me dy tri faqe të thoni u mbyllën lojërat e fatit. Jo nuk do të mbyllen. Unë jam shumë e sigurt që secili që e ka sot një kazino, ose që i operon këto lojëra të fatit, e ka planin B se ku kanë për t'i çuar ilegalisht që absolutisht s'kemi për t'i parë dhe edhe ma zi kanë për t'u marrë në qafë të gjithë ata që janë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Avdullah Hoti, urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam analizuar Projektligjin që na ka ardhur dhe ky projektligj nuk është në përputhje me rezolutën që është miratuar në këtë Kuvend, e cila kërkon që Qeveria të nisë procedurat ligjore për mbylljen e të gjitha lojërave të fatit dhe t'i sjellë Kuvendit Projektligjin brenda dite për këtë çështje.

Projektligji thotë që lejohet Lotaria e Kosovës. Unë mendoj për ta thjeshtësuar situatën, ne duhet të votojmë një ligj që është në përputhje me rezolutën që ka ardhur në Kuvend dhe mandej le të merr për obligim Qeveria që të sjellë projektligjin e ri për rregullimin e Lotarisë së Kosovës si institucion publik. Faleminderit!

KRYETARI: Liburn Aliu, urdhëro!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Edhe ne si grup parlamentar, u deklarua pro këtij projektligji dhe pro mbylljes së lojërave të fatit. Por, e dhamë edhe një amendament. Deputetja Arbërie Nagavci sapo e lexoi pak më parë amendamentin. Ndërsa, unë po dua pak më tej të shkoj se çka do të mund të ndodhë me këtë ndryshim, me këtë projektligj të ri, në rast se nuk kalon amendamenti të cilin sapo e propozuam. Ligji thotë kështu. Neni 1: me këtë ligj ndalohen të gjitha lojërat e fatit, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës. Dhe pastaj flet në nenin 2, qysh pjesët e ligjit të vjetër i cili shfuqizohet dhe që kanë të bëjnë me Lotarinë e Kosovës bëhen ose pjesë e ligjit të ri sikurse po thuhet këtu, ose që mbesin në fuqi.

Te Ligji të cilin do ta shfuqizojmë dhe tek i cili flitet për Lotarinë e Kosovës, tregohet qartë sesi do të organizohet ai. Në nenin 9, pika 2, thotë: Statutin e Lotarisë së Kosovës e propozon Bordi menaxhues i Lotarisë së Kosovës të cilin e miraton Qeveria e Kosovës, që i bie që Lotaria e Kosovës e ka statutin e vet, për shkak se ligji është më i ri, më i vjetër. Dhe tash, unë këtu e kam statutin e Lotarisë së Kosovës, i cili e përcakton veprimtarinë e Lotarisë së Kosovës. Këtu te llojet e veprimtarive të cilat parashihet te Lotaria e Kosovës përmendet lojërat numerike, loto, keno, variante të lojërave të ndryshme, lojëra të ngjashme ku rezultatet bazohen në rastësi, tombolat, TV-Bingo, tombola bingo në lokale të mbyllura dhe prognoza sportive Toto. Pra, këtu do të kemi disa lloje të veprimtarive të cilat do të lejohen si veprimtari, si aktivitete të lojërave të fatit, por që këto do të bëhen në kuadër të Lotarisë së Kosovës.

Po ashtu tash, meqenëse Lotaria e Kosovës paska të drejtën të hapë bastore dhe tombola nëpër lokale të mbyllura. Kjo po ashtu në këtë status ia lejon vetes që të ketë bashkëpunim të drejtpërdrejtë me operatorët privatë, dhe thotë, në nenin 3, pika 7: lojërat e Lotarisë nga neni 3, paragrafi 3 i këtij statuti, Lotaria e Kosovës mund t'i realizojë dhe t'i organizojë në bashkëpunim me lotaritë e shteteve të tjera dhe në bashkëpunim afarist me subjektet e tjera juridike të regjistruara si: tregtare, zejtare, hoteliere, ndër të tjera edhe për transaksion të mallrave dhe shërbimeve.

Dhe tjetra, neni 6, pika 3: nëse Lotaria e Kosovës organizon lojëra të përbashkëta në bashkëpunim me lotaritë e shteteve të tjera, ose në bashkëpunim me persona të huaj juridikë, çështjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në kapital, ndarjen e fitimit dhe bartjen e rrezikut në afarizëm, rregullohet me kontratë të veçantë. Çka po i bie? Këto bastoret të cilat po i lejohen Lotarisë së Kosovës, Lotaria e Kosovës mund t'i subkontrakttojë, që i bie këta të njëjti, këto të njëjtat aktivitete që i kemi sot, e për të cilat po themi se kemi për t'i mbyllur, i bie që me këtë ligj nuk do t'i mbyllim. Pra, prapë ka për të pasur bastore, të cilat kanë për të qenë nënkontraktorë të Lotarisë së Kosovës. Prandaj, nëse duam t'i mbyllim, mos të bëjmë lojëra, po ta themi të vërtetën troç, o po i mbyllim, o nuk po i mbyllim. Me këtë ligj, me këtë statut, me këtë mundësi që

Lotaria e Kosovës t'i ketë mundësitë për subkontraktim, nuk mbyllën lojërat e fatit. Lejohen edhe bastoret, edhe tombolat nëpër hapësira të mbyllura kudo, po të cilat kanë për të qenë, ndoshta mbase diku kanë për ta pasur një logo ku do të shkruajë Lotaria e Kosovës.

Ku e dimë ne sot që Lotaria e Kosovës në bazë të këtij statuti nuk ka marrëveshje konkrete me një kompani private? Ndoshta ka. Prandaj, nëse duam t'i mbyllim lojërat e fatit, ta lëmë lojën, po të flasim troç, po i mbyllim lojërat e fatit që i bie, në rregull po e lëmë Lotarinë e Kosovës, ama po e lëmë vetëm si publike, si shtetërore, pa të drejtë që Lotaria e Kosovës të mund veprimtarinë e veta t'ia subkontrakttojë dikujt tjetër dhe prapë Kosova të na mbushet me lojëra të fatit, të cilat janë nënkontraktorë të Lotarisë së Kosovës.

Pra, ky ligj që e kemi sjellë me këtë nenin 1 dhe nenin 2, që e lejon Lotarinë e Kosovës dhe që asaj statuti pastaj ia lejon të subkontrakttojë veprimtarinë të tjerët, realisht nuk i mbyll lojërat e fatit. Prandaj, nëse nuk ndryshon thelbësisht kjo, nëse nuk e futim këtë amendament, ne po i rrejëm qytetarët e Kosovës që jemi duke i mbyllur lojërat e fatit.

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm mos të harrojmë se ky është Kuvendi i Republikës së Kosovës e ne e vendosim. Do të thotë, ministri e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit deputetë,

Siç po shihet ka një konsensus të përgjithshëm në Kuvend sa i përket, apo të shumicës së deputetëve, shumicës absolute të deputetëve sa i përket pjesën tjetër.

Debati po zhvillohet sa i përket Lotarisë së Kosovës. Është në autoritetin e komisioneve dhe të Kuvendit. Nëse Kuvendi vlerëson që ligji duhet të shfuqizohet në tërësi, atëherë është në autoritetin e Kuvendit, ligji zhvendoset në tërësi. Nëse ka vullnet pastaj të institucioneve, të Kuvendit, të Qeverisë dhe të gjitha të tjerëve, që Lotaria e Kosovës të organizohet me një ligj të veçantë, i cili e precizon fushëveprimtarinë e tij, është prapë në autoritetin e Kuvendit.

Prandaj besoj që Kuvendi do të japë propozimin më korrekt, më të mirë me të gjitha elementët duke pasur konsideratë që realisht nëse dikush dëmtohet, mos t'i jepet mundësia tjetër që dikush të përfitojë prej veprimeve të caktuara.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe dy deputetë. Për faktin, Bilall e ke kërkuar fjalën, si deputet. Dëshiron tash apo më vonë? Menjëherë, a po? Po, thashë të të lë më vonë se në fund... Bilal Sherifi, shef të grupit parlamentar e ke Milaim. Bilal Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Vërtet kësaj radhe do të flas shkurt.

Unë për vete kam besuar që Lotaria e Kosovës është veç ajo që del televizion ato golat që i tërheqin. Sinqerisht po ju them.

Prandaj, mora fjalën që t'i kërkoj falje Naitit, se paska pasur të drejtë, me shpjegimet që i bëri Liburni.

Prandaj, nga ky moment ndryshon. Edhe në emër të Nismës ndryshon pozicioni. Nuk mund ta mbështesim këtë ligj kështu siç është sepse vërtetë mund të shkojmë në drejtim të krijimit të monopolit.

Pra, unë në injorancën time, duke menduar se Lotaria e Kosovës është vetëm ajo që del një ditë në televizion edhe ku i mbushim kryqet me numra, unë i dhashë mbështetje. Por, tash ndryshon hesapi. Ndryshon puna dhe duhet që kjo çështje të shqyrtohet seriozisht. Ose po shkojmë deri në fund, dhe nuk po bëhemi sikur ishim duke bërë diçka e në fakt thuajse s'paskemi qenë duke bërë jo bash asgjë, por jo gjithçka që e premtuam. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën. Milam, të lutem menjëherë do ta kesh fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Së pari sinqerisht dua t'ju them kolegeve dhe kolegëve deputetë të cilët vërtetë nuk e di a po dëgjojnë vetveten, presionin që po e bëjnë me mikrofon duke bërë titur e duke e pasur mikrofonin. Kujdes pas se, sinqerisht pa bërë titur.

Tani në këtë rast unë vërtetë nuk munda të kuptoj, përjashtoj kryetarin e Komisionit për Buxhet e Financa që me të drejtë e ngriti një shqetësim të cilin, pikërisht janë deputetët dhe ky Kuvend me komisionin përkatës që duhet ta rregullojnë edhe marrin përgjegjësinë.

Pra, është ky Kuvend që po kërkon dhe ka kërkuar edhe në seancën e jashtëzakonshme ku shumë prej atyre që vërtetë e kanë pasur nënshkrimin, për t'i mbyllur lojërat e fatit.

Tash, a thua ata biznesmenë të lojërave të fatit kanë ndonjë shoqe apo ndonjë shok në Kuvendin e Republikës së Kosovës që po kërkojnë edhe disa ditë shtesë.

Tani, vërtetë unë e kam këtu shqetësimin, tash a po duam që t'i mbyllim apo nuk po duam që t'i mbyllim. Me gjithë ato bërë titur mendova që bukur shumë zëri ju shkonte po dilemat janë në momentin që kemi vendosur, Kuvendi dhe Qeveria e ka luajtur rolin e vet dhe në afatin prej 6 ditësh e ka sjellë projektligjin në Kuvend me seriozitetin që e ka pasur.

Sa jemi ne serioz si deputetë, si kërkues për t'i mbyllur këto lojëra të fatit, atëherë është pikërisht në dorën e deputetëve është në dorën e Kuvendit.

Nëse duam tash të kërkojmë tani edhe disa ditë shtesë, atëherë vjen në shprehje normal përfitimi i atyre që kanë përfituar. A po duam që t'i mbyllim apo nuk po duam që t'i mbyllim? Ngase dikujt i luan lotaria ndoshta edhe për 24 orë.

Pra, puna është në dorën e deputetëve. Në komisionin përkatës, sidomos për çështjen e lotarisë, aty nuk jam eksperte dhe pres prej Komisionit Funkcional që vërtet ta zgjidhë këtë çështje. Për mua problem është pak titulli, por prapë nuk e di meqë juriste nuk jam, titulli i Projektligjit për Ndalimin e lojërave të fatit dhe kërkesa për çështje të Lotarisë së Kosovës.

Pra, edhe njëherë; a jeni për t'i mbyllur lojërat e fatit apo po kërkoni afat shtesë?

Kjo është dilema ime që e pashë këtu, ngase nuk e di, unë po dua që të besoj që deputetët nuk e dinë që janë pikërisht deputetët me të gjitha përfaqësimet e tyre si grupe parlamentare në komisionin përkatës që mund të bëjnë amendamente dhe askush nuk ka të drejtën për tua ndalur.

Qoftë me një afat kohor më të shpejtë. Pra, në momentin që amendamentet e propozuara nuk pranohen, atëherë do të duhej ta dimë se kush nuk i ka votuar ato amendamente. Pse nuk janë votuar? Cilat subjekte politike nuk i kanë votuar? Dhe atëherë dalin interesat, ku do t'i shohim pak edhe ne të tjerët që nuk kemi shokë e shoqe nëpër këto biznese.

Pra, sa është Kuvendi, sa janë deputetët serioz. Sinqerisht kërkoj që ta shoh edhe atë përvojën, jo me ngutë por me profesionalizëm për të bërë veprime që janë kërkuar me rezolutë, ku të gjithë kemi qenë njëjtë, pra për t'i mbyllur lojërat e fatit pa dashur të ndalem në atë që e tha doktori se, të hyj në histori u tuta mos po dal mjeke edhe unë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, pastaj Ismal Kurteshi dhe në fund kryetari i Komisionit, Lumir Abdixhiku.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Së pari iniciativa e krejt kësaj çorbe të prishtë ka ardhur dhe është nisur me hile. Ata që e kanë sjellë këtë iniciativë së pari të qytetarët e Kosovës kanë hapur një fushatë se, a e dini e ju kush po e dirigjon edhe po e udhëheqë bixhozin në Kosovë, kazinotë, lojërat e fatit.

Qytetarët: Jo valla nuk e dimë. E, është kryeministri, vetë Ramush Haradinaj. Ai, ai i ka nën kontroll. Edhe këta kanë thënë se ne e kapim në penal kryeministrin. E bëjmë propozimin edhe kryeministri nuk do t'i mbyllë. Tani u vërtetua se ia i mbylli. Edhe sikur t'i pyesim këta që e kanë marrë iniciativën, këta i kanë rënë fort pishman për këtë punë.

Këta e dinë që kjo është njëra nga iniciativat më kriminale që ka marrë Parlamenti i këtij vendi. Ne jetojmë në një vend ku ne i kemi kapur qytetarët tanë. Qytetarët që kanë ardhur që të kërkojnë strehim te ne, i kemi kapur qytetarët turq ua kemi lidhur sytë e i kemi dërguar në burg dhe askush nuk ka marrë përgjegjësi.

Kur ne jemi shtet i Burdushit që rrezikojmë jetën e qytetarëve. Kur ne jemi shtet mafioz që e rrezikojmë jetën e qytetarëve pse të mos luajmë ne edhe me lojërat e fatit. Pse mos t'i dëmtojmë ne 15 mijë familje, 15 mijë punëtorë? Pse mos t'i dëmtojmë ne ata njerëz, qytetarë të Republikës së Kosovës, po edhe qytetarë të vendeve të tjera që kanë ardhur dhe kanë paguar për licencë 300 mijë euro deri në gjysmë milioni edhe sot ku është përgjegjësia e shtetit. Kush ua kthen këto para?

Pse nuk erdhëm avash-avash dhe të themi; ngadalë, do i mbyllim lojërat e fatit, sikurse Shqipëria që dha afat dy vjet. T'ju tregohet njerëzve dhe t'ju thuhet se, sot dy vjet ne do t'i mbyllim lojërat e fatit. Po, jo!

Thanë se kanë ndodhur vrasje. Po vrasje kanë ndodhur edhe në pompa të benzinës. Eja i mbyllim të gjitha pompat e benzinës. Vrasje kanë ndodhur nëpër spitale. Po i rrahin mjekët. Eja i mbyllim repartet dhe e lëmë këtë vend pas spitale.

Një kolegë deputet tha se rrezikohet familja dhe jeta. Jo bre, këtu më kollaj po blihet drogë se fasule. Nuk rrezikohet jeta ngase krejt vendet evropiane, krejt Las Vegas është me lojëra të fatit. Krejt vendet e botës i kanë lojërat e fatit. Edhe AKI-në duhet ta mbyllim, për shembull se kanë ndodhur vrasja në kafiterinë e AKI-së.

E tash çfarë kemi ne, ia kemi hequr buxhetit të Republikës së Kosovës, 30 milionë euro. Me ato 30 milionë do ta kishim ndërtuar në çdo fshat të Kosovës nga një çerdhe.

E kemi shkatërruar biznesin. I kemi dërguar mesazh botës që, badihava vjen ti këtu dhe nxjerrë licencë për një biznes, po flas për një biznes, sepse Qeveria e Kosovës me deputetët e saj bëjnë rezolutë edhe ta marrin licencën e biznesit.

Sikurse lojërat e fatit, sikurse një licencë për rrymë për energji elektrike, është identike. E tani ne do të shtyhem pas ditës së sotme se kë do ta çojmë në bord të Lotarisë së Kosovës, ngase tash atje do jenë paratë.

Kështu që, tash nëse mundemi ta bëjmë ndonjë kompromis që ta lëmë dikë prej këtyre iniciatorëve që ta sjellin atë rrotën e t'i kapin ato goglat do të ishte mirë, e keni të qartë. Edhe ne po u çojmë një mesazh të rëndë vendeve perëndimore. Po u çojmë mesazh të rëndë ambasadave

të instaluara në Kosovë. Sepse me një rezolutë pse i teket dikujt, ne mund të nxjerrim vendime shtetërore dhe qeveritare që e dëmtojnë rëndë biznesin e këtij vendi.

Të nderuar deputetë,

Kur ne jemi mbledhur në këtë Parlament dhe kemi bërë seancë të jashtëzakonshme për një fatkeqësi që i ka ndodhur një vajze në Drenicë. Ne çfarë nuk bëjmë. Kur ne e dimë që me qindra raste të pedofilizmit janë brenda kishës katolike e ndodhin në të gjithë botën, e në Gjermani kurrë nuk është mbledhur Bundestagu për gjëra të tilla.

Ndërkaq te ne kujt po i teket po vjen me ndonjë propozim dhe eja të bëjmë seancë të jashtëzakonshme.

Prandaj, ju bëj ftesë deputetëve të Parlamentit të Kosovës. E përkrahi në mënyrë absolute fjalimin e Liburn Aliut edhe të shumë deputetëve të tjerë, reflektoni, mendoni dhe mos ta votojmë një ligj që është me të vërtetë antibiznes, antinjerezor dhe i cili e dëmton rëndë biznesin e këtij vendim dhe i lë pa punë 15 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Denbabaden ka ekzistuar bixhozi. Prej kemi luajtur kapuças, kur i kemi fshehur kokrrat e fasules ndër kapuças e deri sot, edhe do të ekzistojë.

Prandaj, unë zoti kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, kurrë nuk e votoj një ligj të tillë.

KRYETARI: Liburn Aliu, sigurisht iu përmend emri, ka replikë.

LIBURN ALIU: Unë në fjalimin tim dhashë vërejtjet për projektligjin dhe mundësinë që mund të lejojë vazhdimin e lojërave të fatit. Jo që jam kundër projektligjit, pra ne jemi për projektligjin, jemi për mbylljen, por jemi për mbylljen dhe për pamundësimin e subkontraktimit të lojërave të fatit në Kosovë edhe nëse kjo ndodh nëpërmjet Lotarisë së Kosovës.

KRYETARI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën. Jemi në përfundim të debatit. Pastaj edhe kryetari i Komisionit.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Meqë po bëhet fjalë vërtetë për një ligj të rëndësishëm për vendin tonë, kjo nguti të cilën edhe ne u pajtuam që të ndodh diçka me nguti, vërtetë nuk na çon te një zgjidhje e drejtë.

Prandaj, unë mendoj se sa i përket Ligjit për ndalimin e lojërave të fatit e përkrah në këtë formë, në Nenin 1, kisha përkrahur tekstin, me këtë ligj ndalohen të gjitha lojërat e fatit. Pa këtë pjesën në përjashtim.

Në nenin 2, me këtë ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për lojërat e fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerr për zbatimin e tij. Dhe atë pjesën tjetër e kisha hequr. Që do të thotë se mbyllen të gjitha lojërat e fatit dhe pastaj nëse ka nevojë vendi për Lotarinë e Kosovës, Qeveria le ta hartojë në ligj për Lotarinë e Kosovës me procedurë të rregullt, le të vjen në Kuvend dhe të kalojë ashtu si është i pranueshëm për Kuvendin.

Por, me përjashtimin për Lotarinë e Kosovës, ne po futemi në njëfarë fushe të cilën nuk jemi të sigurt se a po i mbylлим lojërat e fatit apo po ia vazhdojmë jetën vetëm në një formë tjetër e që u tha edhe më herët duke i monopolizuar ato dhe duke i futur nën ombrellën e vetëm një organizimi që në të vërtetë nuk i sjell asnjë të mirë vendit.

Aty vetëm ndërrohen ata pronarët dhe përfituesit, po vendi humb njësoj.

Prandaj, ju lutem, sonte mendoj se duhet të votohet ligji që të mbyllen lojërat e fatit së bashku me Lotarinë e pastaj për Lotarinë të bëhet ligj i veçantë, sepse edhe shtimi i asaj pjese të ligjit ekzistues është më i madh se vetë ligji.

Kërkohet të shtohen tri nene dhe i numërova edhe pikat edhe 28 pika që nuk lejohet amendamenti me qenë më shumë se vetë ligji. Një ligj mund të amendamentohet deri 40% e kështu po i bie një ligj të amendamentohet deri në 300% dhe kështu ai më nuk është ligj, është diçka krejt tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndër kohë janë lajmëruar edhe dy kolegë deputetë. Kryetar e komisionit e dëshiron fjalën apo në fund? Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Në vijë me diskutimet që u bënë këtu. Me çështjen e ngritur rreth paradoksit ligjor, unë vij me propozimet edhe të ministrit të Shëfit të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rezolutës që është aprovuar këtu dhe për hir të amendamentit që u propozua nga Vetëvendosja, po më duket që në kohë të shkurtë që jemi, pra në pamundësi që ta adresojmë mirë çështjen e Lotarisë, zgjidhja më optimale do të kishte shfuqizimi i të gjitha lojërave të fatit.

Pastaj të kërkohet nga Qeveria që të na vjen me ligj të ri mbi Lotarinë e Kosovës në të cilin ne do t'i adresojmë këto brenga që i kemi. Me këtë propozim ju kisha lutur që të na lironi neve si komision që sa më shpejt t'i kryejmë këto çështje, amendamentimet shpejt dhe të kthemi në këtu në seancë me raport të ri në këtë vijë. Faleminderit!

KRYETARI: Në qoftë se kemi mirëkuptimin, vetëm edhe një deputet është, Daut Haradinaj dhe nuk ka të tjerë. U tërhoq, dhe pastaj shkojmë në votim. I kisha lutur deputetët që janë në sallë, në ambientet e Kuvendit, le të kthehen në Kuvend, jemi në votim.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk dua ta zgjasë shumë, vetëm se po i shoh disa opinionin për dhe kundër sot pavarësisht asaj që javën e kaluar, ne patëm këtu një proces votimi rreth një rezolute ku 74 ose 75 deputetë nëse nuk gaboje e votuan atë rezolutë, në të cilën rezolutë ishin vetëm dy pika.

E para ishte që menjëherë të merret vendimi për ndërprerjen e lojërave të fatit dhe e dyta ishte, të angazhohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta bëjë ose ta harmonizojë ose ta procedojë nxjerrjen e një ligji të ri i cili ndalon të gjitha lojërat e fatit dhe kazinotë, pika, pika, pika.

Të njëjtit njerëz të cilët edhe e kanë nënshkruar thirrjen e asaj seance të jashtëzakonshme, sot i dëgjova me vesh të mi që janë kundër. Unë tash s'po i kuptoj vëllai im, atë ditë me shumë urgjencë erdhën në sallë e tash janë kundër. Tashti, nuk po dua që asnjërit t'ia drejtoj gishtin, por unë pajtohem plotësisht me kolegët e mi që duhet të mbyllën të gjitha, përfshirë edhe Lotarinë e Kosovës, deri në krijimin e një ligji të ri.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në votim për faktin se s'ka më asnjë deputet. S'e ka kërkuar fjalën as përfaqësuesi i Qeverisë. Procedojmë me votimin në parim të projektligjit. Është leximi i parë, menjëherë do ta kemi në leximin e dytë, keni parasysht.

Të keni parasysht vetëm diçka; diskutimet përfunduan. Në qoftë se dëshirojmë që sot të marrim vendim mes leximit të parë dhe të dytë. Në qoftë se e kemi me të vërtetë, e unë besoj që e kemi vërtetë që sot të mbyllën të gjitha me Lotari e të gjitha.

Po, leximi i parë kryhet tash, kështu si është. Shkon komisioni, dhe në orën 18:00 takohemi prapë në lexim të dytë. Më duket ishte shumë i qartë Kuvendi me diskutimet e tij. E votojmë në parim projektligjin në lexim të parë, votojmë tash. 63 deputetë kanë votuar, 60 për dhe 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në bazë të vendimit të Kuvendit, datë 28 mars 2019 ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së tanishme plenare. Seanca tjetër fillon në 19:30 për arsye se duhen... Më falni, ngase ma sollli Administrata. Varet prej jush, unë mund ta lë edhe në orën 18:00, por mos më fajësoni mua në qoftë se komisioni... Në 18:30, por pastaj varet prej komisioneve. Por, ta kryejmë sonte.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë